

AGNA Sh.a.

**Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(individuale)**

PËRMBAJTJA

Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit apo Humbjes dhe e të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	3
Pasqyra e Flukseve të Parasë.....	4
1. Informacion mbi Shoqërinë.....	5
2. Baza e përgatitjes	5
3. Gjykime të rëndësishme kontabël, vlerësime dhe supozime	5

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Më 31 dhjetor 2022

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Aktivitet			
Aktivitet afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	7	6,622,298,401	6,911,846,256
Aktive afatgjatë jomateriale	8	57,965,236	65,917,580
Aktive afatgjatë financiare	9	1,300,350,168	953,660,168
Totali i aktiveve afatgjatë		7,980,613,805	7,931,424,004
Aktivitet afatshkurtra			
Inventarë	10	621,132,645	465,350,686
Llogari të arkëtueshme	11	511,818,139	503,006,356
Të tjera të arkëtueshme	12	3,288,216,873	3,172,942,068
Shpenzime të shtyra	13	28,023,327	26,990,583
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	14	312,641,478	557,193,358
Totali i aktiveve afatshkurtra		4,761,832,462	4,725,483,051
Totali i aktiveve		12,742,446,267	12,656,907,055
Detyrimet			
Detyrimet afatgjatë			
Huamarrje afatgjatë	15	1,039,683,988	808,788,269
Detyrime afatgjatë të tjera	16	62,826,500	66,418,000
Totali i detyrimeve afatgjatë		1,102,510,488	875,206,269
Detyrime afatshkurtra			
Huamarrje afatshkurtra		580,958,046	829,665,693
Detyrime të pagueshme ndaj furnitorëve		198,826,039	175,431,829
Detyrime të tjera		2,171,858,202	2,619,852,613
Totali i detyrimeve afatshkurtra		2,951,642,287	3,624,950,135
Totali i detyrimeve		4,054,152,775	4,500,156,404
Kapitali i vet			
Kapitali aksionar		6,250,900,000	6,250,900,000
Rezerva ligjore		363,490,651	332,900,545
Fitime të pashpërndara		1,542,360,000	960,760,003
Fitim i vitit		531,542,841	612,190,103
Totali i kapitalit të vet		8,688,293,492	8,156,750,651
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		12,742,446,267	12,656,907,055

Pasqyrat Financiare në faqet 1 deri 4 janë firmosur dhe aprovuar më 20 mars 2022 nga:

Kristo Naçi
Administratori

Benard Pula
Përgjegjës i Financës

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet bashkë me grupin e shënimeve në faqet 5 deri 27 që përbëjnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

AGNA SHA*(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

Pasqyra e Fitimit apo Humbjes dhe e të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhurat		
Të ardhura nga shitja	16,620,721,123	16,397,587,694
Kosto e mallit të shitur	(15,389,417,610)	(15,146,947,543)
Të ardhura bruto nga shitja	1,231,303,513	1,250,640,151
Të ardhura të tjera nga aktiviteti	520,478,456	326,480,512
Të tjera të ardhura	482,488,248	0
Te ardhura të tjera	1,002,966,704	326,480,512
Shpenzime personeli	(355,624,922)	(339,190,204)
Shpenzime amortizimi	(174,390,720)	(173,650,833)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	(928,306,183)	(252,212,838)
Fitimi nga aktiviteti operativ	237,912,829	812,066,788
Të ardhura financiare	236,423,442	129,508,708
Shpenzime financiare	(354,568,142)	(220,055,407)
Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare	(118,144,700)	(90,546,699)
Fitimi Para Tatimit	657,803,692	721,520,089
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	(126,260,851)	(109,329,986)
Fitimi (humbja) neto	531,542,841	612,190,104
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	531,542,841	612,190,104

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e vendosura në faqet 5 deri 27 që përbëjnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

AGNA SHA*(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)***Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital****Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2022**

	Kapitali	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Fitim i akumuluar	Fitim i vitit	Totali
Më 1 janar 2021	6,250,900,000	310,343,059	0	532,160,000	451,157,486	7,544,560,545
Ndryshim ne politikat kontabel						
Rritje kapitali						
Totali i veprimeve me aksionerët	6,250,900,000	310,343,059	0	532,160,000	451,157,486	7,544,560,545
Transferim i fitimit te vitit 2020		22,557,486		428,860,000	(451,157,486)	0
Fitimi i vitit 2021						
Shperndarje dividendi					612,190,104	612,190,104
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse						
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse					612,190,104	612,190,103
Gjendja më 31 dhjetor 2021	6,250,900,000	332,900,545	0	960,760,000	612,190,104	8,156,750,649
Më 1 janar 2022	6,250,900,000	332,900,545	0	960,760,000	612,190,104	8,156,750,649
Transferim i fitimit te vitit 2021		30,590,106		581,600,000	(612,190,107)	0
Shperndarje dividendi						
Fitimi i vitit 2022					531,542,841	531,542,841
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse						
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse					531,542,841	531,542,841
Gjendja më 31 dhjetor 2022	6,250,900,000	363,490,651	0	1,542,360,000	531,542,841	8,688,293,492

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet bashkë me grupin e shënimeve në faqet 5 deri 27 që përbëjnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

AGNA SHA**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)***Pasqyra e Flukseve të Parasë***(metoda direkte)***Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2022**

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2021
Flukset e parasë nga veprimtaritë shfrytëzuese		
Mjete monetare të arkëtuara nga klientët	16,688,211,044	17,055,566,959
Mjete monetare të paguara ndaj furnitorëve dhe punonjësve	(15,868,091,344)	(15,487,872,899)
Mjete monetare të arkëtuara nga veprimtari të tjera	936,828,347	294,228,041
Interesa të paguara	(52,006,343)	(58,294,228)
Rimbursim tatime	0	3,616,929
Pagesa për tatime, taksa e derdhje të ngjashme	(165,559,121)	(16,826,538)
Pagesa për shpenzime të tjera	(1,699,550,147)	(423,615,633)
Flukset neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit	(160,167,564)	1,366,802,631
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese		
Blerje aktivesh afatgjata materiale	(355,345,285)	(349,271,920)
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	482,853,686	0
Rimarrje e aktiveve afatgjata materiale	7,952,344	12,429,000
Flukset e përdorura për veprimtaritë investuese	135,460,745	(336,842,920)
Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese		
Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar	(189,106,679)	(95,176,000)
Hua nga ortakët	(9,334,954)	(51,437,430)
Kthimi i huave të marra		
Huamarrje afatshkurtëra	(248,707,647)	(110,162,770)
Huamarrje afatgjata	227,304,219	(322,637,593)
Dividend i zakonshëm i paguar		
Flukset e përdorura në veprimtaritë financuese	(219,845,061)	(579,413,791)
Rritja neto e flukseve të parasë	(244,551,880)	450,545,920
Mjete monetare në fillim të periudhës	557,193,358	106,647,438
Mjete monetare në fund të periudhës	312,641,478	557,193,358

Pasqyra e lëvizjes së flukseve monetare duhet të lexohet bashkë me grupin e shënimeve në faqet 5 deri 27 që përbëjnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

AGNA SHA

Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)

1. Informacion mbi Shoqërinë

Shoqëria “AGNA” sha (këtu më poshtë “Shoqëria”) është themeluar si një shoqëri me NIPT:J62903631L. Shoqëria ushtron aktivitetin privat që prej vitit 1993, e regjistruar pranë regjistratit tregëtar me Nr. 8827 në datën 14.12.1993 të Gjykatës së rrethit Tiranë dhe me emërtimin e mëparshëm “Anonime Kakavi sha”. Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është në fushën e tregtisë të përgjithshme, import-eksport me pakicë dhe shumicë, veprimtari në fushën e transportit të mallrave, veprimtari në fushën e investimit për ndërtim, shitblerje trojesh për ndërtim, etj.

Selia qendrore e Shoqërisë është në fshatin Vrisera, Gjirokastrë. Shoqëria ushtron aktivitetin edhe në adresa sekondare të deklaruara pranë organeve tatimore.

Aksionerët e Shoqërisë janë:

1. Z.Kosta Sotiri, i cili zotëron 32.5% të kapitalit;
2. Z.Vasil Naci, i cili zotëron 32.5% të kapitalit;
3. Z.Kristo Naci, i cili zotëron 30% të kapitalit; dhe
4. Z.Aleksandër Naci, i cili zotëron 5% të kapitalit.

Më 31 dhjetor 2022 Shoqëria administrohet nga Z.Kristo Naci (2021: Z.Kristo Naci).

Më 31 dhjetor 2022 Shoqëria kishte 240 punonjës (2021 :247)

2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare përgatiten duke u bazuar në koston historike dhe parimin e vijueshmërisë, me përjashtim të disa kategorive të aktiveve dhe detyrimeve, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Keto standarte janë të detyrueshme në bazë të Urdhrit të Ministrisë së Financave nr.65, datë 25 maj 2008 “Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, të përkthyer në gjuhën shqipe.”

Shoqëria i mban të dhënat e kontabilitetit dhe i publikon pasqyrat financiare në pajtueshmeri me ligjin mbi kontabilitetin nr. 25, datë 10 maj 2010 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

3. Gjykime të rëndësishme kontabël, vlerësime dhe supozime

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Shoqëria kryen supozime dhe bën vlerësime të cilat kanë ndikim në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Çmuarjet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazuar në eksperiencën e kaluar dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe parashikimet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet që janë të arësyeshme sipas rrethanave.

Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në ato pasardhëse të ndikuara nga ky ndryshim. Në veçanti, informacioni mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve të rëndësishme në aplikimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar më poshtë.

Parimi i vijimësisë dhe krahasueshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e vijueshmërisë.

Informacioni krahasues është paraqitur në përputhje me politikat kontabel që zbatohen nga Shoqëria. Janë bërë korigjimet e nevojshme për shifrat krahasuese në përputhje me ndryshimet në paraqitjet në periudhën aktuale.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Nuk ka politika kontabël dhe dhënie informacionesh shpjeguese të rëndësishme të adoptuara nga Shoqëria, të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe pasivet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime matjeje dhe/ose prezantimi bazuar në metodat në vijim. Supozimet në përcaktimin e vlerës së drejtë, kur janë të aplikueshme, prezantohen në shënimin përkatës.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat. Në përcaktimin e provizioneve të tatimit mbi të ardhurat janë të nevojshme çmuarjet. Ekzistojnë shumë transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurtë gjatë veprimtarisë normale të biznesit. Shoqëria njeh detyrimet për vlerësimet e organeve tatimore bazuar në vlerësimet nëse tatime të tjera shtesë do të lindin si detyrime. Nëse më pas ka diferencë midis detyrimit faktik dhe atij të regjistruar atëherë këto diferenca do të ndikojnë në tatimin mbi të ardhurat dhe provizionet për tatime në periudhën në të cilën është kryer ky krahasim.

4. Përmbledhje e politikave bazë kontabël

Polikat kontabël si më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në gjithë periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

(a) Transaksionet në monedha të huaja

Regjistrimet kontabël të Shoqërisë përgatiten në Lekë, që është monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku operon Shoqëria.

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në monedhën Lek, duke aplikuar mbi monedhën e huaj kursin e momentit të këmbimit të kësaj monedhe me Lek-un në datën e veprimit (kursi spot). Aktivet monetare dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e raportimit të pasqyrave financiare konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja/pagesa e mjeteve monetare ose nga konvertimi i mjeteve monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga ato që janë përdorur në njohjen fillestare gjatë periudhës ushtrimore aktuale ose në pasqyrat financiare të mëparëshme, njihen si fitim ose humbje e periudhës ushtrimore kur ndodh diferenca. Mjetet jo-monetare që njihen me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e veprimit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë janë të vlerësuar me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është vendosur. Diferencat e këmbimit nga rivlerësimi në datën e bilancit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Euro	114.23	120.76
USD	107.05	106.54

(b) Aktivet afatgjata materiale*i) Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kosto përfshin shpenzime që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, si dhe kostot e çmontimit, largimit dhe restaurimit të vendit ku janë vendosur.

Programet kompjuterike të blera, të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të pajisjes përkatëse, kapitalizohen si pjesë e saj.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo datë raportimi.

Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë si më poshtë:

	2022	2021
Ndertesa	5%	5%
Pajisje dhe makineri	20%	20%
Pajisje zyre	20%	20%
Pajisje informatike	25%	25%
Mjete transporti	20%	20%
Te tjera	20%	20%

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale c'regjistrohet kur nxirret jashte perdorimit apo shitet ose kur nuk priten perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi ose shitja. Cdo fitim ose humbje qe rrjedh nga mosnjohja (c'regjistrimj) i aktivit (llogaritur si difference mes te ardhurave nga pakesimi dhe vleres kontabel te aktivit), paraqitet ne te ardhura ose shpenzime kur aktivi c'regjistrohet.

Vlera e mbetur e aktivit, jeta e dobishme dhe metodat e amortizimit rishikohen cdo periudhe financiare, duke bere ndryshimet e nevojshme sipas rastit ne fund te cdo viti financiar.

(c) Aktivet afatgjata jomateriale*(i) Njohja dhe matja*

Aktivët jomateriale të blera nga Shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënien në vlerë të akumuluar.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivi specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mire dhe markës, njihen në fitim ose humbje në momentin e ndodhjes.

(iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e aktiveve, ose cdo vlerë tjetër të konsideruar si kosto, minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime duke përdorur metodën e vlerës lineare me një normë vjetore amortizimi 15% për cdo aktiv.

(d) Zhvlerësim i aktiveve jo financiare

Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit në mënyrë që të përcaktohet zhvlerësimi. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes.

Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontojnë flukset e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimit para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivit, për të cilat nuk janë bërë rregullime në vlerësimet e bëra për fluksin e mjeteve monetare.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

(e) Inventarët

Inventarët mbahen në vlerën më të ulët të koston dhe të vlerës neto të realizueshme. Kostoja përfshin koston direkte dhe ato indirekte që janë shkaktuar për sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe kushtet e tyre aktuale. Kostoja e inventarëve përfshin: koston e blerjes së mallit, koston e transportit, detyrimet doganore, akcizën etj.

Vlera neto e realizueshme (VNR) paraqet çmimin e vlerësuar të shitjes për inventarët minus shpenzimet e nevojshme për të bërë shitjen.

Manaxhimi i Shoqërisë gjatë vitit monitoron në mënyrë periodike çmimet e shitjes me koston e inventarëve dhe në qoftë se çmimi është ulur nën koston, diferenca njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse si zhvlerësim i inventarëve.

Kostoja e inventarëve është e bazuar në metodën mesatare të koston. Zhvlerësimi i përshtatshëm për ulje të vlerës njihet në fitim dhe humbje kur ka evidencë objektive që VNR është më e ulët se kostoja.

(f) Instrumentat financiarë

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, paratë dhe ekuivalentët e tyre, llogari të pagueshme tregëtare dhe të tjera, të arkëtueshme dhe të pagueshme nga njësitë ekonomike të grupit.

Aktivet Financiare*i) Njohja dhe matja fillestare*

Aktivet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) dhe vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar dhe nga modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre. Përveç llogarive të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të rëndësishëm financimi ose për të cilat Shoqëria ka zbatuar lehtësimet praktike të standartit, Shoqëria mat një aktiv financiar me vlerën e drejtë të tij plus koston e transaksionit, kjo në rastin e një aktiviteti financiar të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe të matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, ai duhet të krijojë flukse të mjeteve monetare që janë 'vetëm pagesa e principalit dhe interesit (SPPI)' për shumën kryesore të papaguar. Ky vlerësim quhet test SPPI dhe kryhet në nivel instrumenti financiar.

Modeli i biznesit i Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve financiare i referohet mënyrës se si menaxhon aktivet e saj financiare në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare. Shoqëria ka aktive financiare të arkëtueshme tregëtare nga të cilat pret vetëm arkëtimin e principalit dhe interesit në rast se aplikohet.

ii) Matja e mëpasshme

Për qëllime të matjes së mëpasshme, aktivet financiare klasifikohen në katër kategori:

- Aktivet financiare me koston e amortizuar (instrumentet e borxhit);
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes OCI me riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentet e borxhit);
- Aktivet financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes OCI pa riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative në momentin e çregjistrimit (instrumentat e kapitalit neto);
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Aktivet afatgjata financiare

Shoqëria ka investime në filiale dhe në pjesëmarrje si aktive afatgjata financiare. Për filialet shoqëria zbaton nga 1 janari 2019 SNRF 10 Pasqyra financiare të Konsoliduara për shkak të detyrimit ligjor për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara (Ligji nr.25 datë 10 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Për pjesëmarrjet shoqëria zbaton SNK 28 Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta.

Aktivet financiare me koston e amortizuar

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)

Shoqëria ka aktive financiare vetëm të kategorisë së parë. Shoqëria mat aktivet financiare me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes së mjeteve financiare për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe
- kushtet kontraktuale të aktivit financiar të japin rritje në data të përcaktuara flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.

Aktivet financiare me kosto të amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv (në qoftë se me kamatë) dhe janë subjekt i rënies në vlerë (zhvlerësimi). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet.

Aktivet financiare të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të drejta të arkëtueshme.

i) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivit financiar, janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar.

Shoqëria mund të bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

ii) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet për zhvlerësim në rast se ekziston evidencë objektive që tregon që një ose më shumë ngjarje kanë efekt negative mbi fluksin e ardhshëm të parave të gjeneruara nga ky aktiv.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së tij kontabël në pasqyrat financiare dhe vlerës aktuale të flukseve të vlerësuara të ardhshme të parasë, të skontuara me interesin fillestar efektiv.

Aktivet financiare individualisht të rëndësishëm, janë testuar për zhvlerësim mbi baza individuale. Aktivet e mbetura financiare janë vlerësuar së bashku në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret në rast se rimarrja mund të lidhet në mënyrë objektive me ngjarje që ndodhin pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Rimarrja njihet në fitim ose humbje.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë një zë shumë i rëndësishëm për Shoqërinë. Një e arkëtueshme përfaqëson të drejtën e Shoqërisë për një shumë të konsiderueshme që është e pakushtëzuar (dmth., kërkohet vetëm kalimi i kohës para pagesës së shumës).

Detyrimet Financiare

(i) Njohja fillestare dhe matja

Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, si detyrime financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kreditë dhe huamarrjet, të pagueshme ose si derivativë të përcaktuar si instrumente mbrojtës në një mbrojtje efektive, sipas rastit.

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e huave dhe të pagueshmeve, neto nga kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen.

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë detyrimet tregtare, dhe të tjera të pagueshme të cilat janë të gjitha klasifikuar si të mbajtura me kosto të amortizuar.

(ii) Matjet e mëvonshme

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:

- detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes;
- me kosto të amortizuar.

Shoqëria nuk mban asnjë detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes, dhe nuk ka ndonjë hua apo huamarrje.

(iii) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë.

Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet një detyrim financiar i ri, me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara.

Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë cdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet si fitim ose humbje.

(g) Provizionet

Një provizion njihet kur, sipasojë e ngjarjeve të kaluara, Shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohet me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim.

(h) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet në vlerën nominale. Aksionet e aksionerëve klasifikohen si kapital aksionar.

(i) Njohja e të ardhurave

E ardhura nga shitja e mallrave dhe të ardhurat e tjera njihen në pasqyrën e të ardhurave ose shpenzimeve në raport me fazën e plotësimit të transaksionit në datën e raportimit.

(j) Shpenzimet operacionale

Shpenzimet operacionale njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ato kryhen.

(k) Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme të përcaktuara

Shoqëria paguan gjatë aktivitetit të saj kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Kostot e këtyre kontributeve njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën kur ndodhin. Autoritetet lokale janë përgjegjës për përcaktimin e pragut minimal për pensionet sipas një plani kontributi të përcaktuar.

Leja vjetore e paguar

Shoqëria njeh si detyrime vlerën e paskontuar të kostove të përlogaritur lidhur me lejen vjetore të parashikuar për tu paguar si shkëmbim i shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

Përfitimet afatshkurtra

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)

Përfitimet afatshkurtra të punonjësve maten me bazë të paskontueshme dhe shpenzohen kur ofrohet shërbimi. Për vlerën e pritshme për tu paguar si përfitim monetar afatshkurtër ose sipas një plani fitim-

shpërndarës krijohet një provizion nëse Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor dhe konstruktiv për të paguar këtë shumë si pasojë e një shërbimi të mëparshëm të dhënë nga punonjësi edhe ky detyrim mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

(l) Pagesat e qirasë

Qiratë klasifikohen si qira financiare kur termat e qirasë transferojnë në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet të qiramarrësi. Të gjitha qiratë e tjera klasifikohen si qira operationale. Pagesat e bëra për qiranë operationale njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes ose të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qirasë. Me hyrjen në fuqi të SNRF 16, nga 1 Janar 2019 e mbrapa, trajtimi i qirave operationale në pozicionin e qiramarrësit ndryshon.

(m) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë fitimet nga kursi i këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare nëpërmjet fitimit dhe humbjes dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare (nëse ka).

(n) Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi përbëhet nga tatimi aktual dhe i shtyrë. Shpenzimi tatim fitimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveçse në rastet kur lidhet me elementë që njihen direkte në kapital, në të cilat njihet direkte në kapital. Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e pasqyrave të pozicionit financiar, duke rezultuar në diferenca të përkohshme ndërmjet vlerës së mbartur të aktiveve dhe pasiveve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që priten të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur anulohen, bazuar në legjislacionin që ka qenë në fuqi ose ka hyrë në fuqi në fund të periudhës së raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që është e mundur që përfitimet e ardhshme të taksueshme do të jenë të vlefshme ndaj diferencave të përkohshme që mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimet e lidhura me atë tatim do të realizohen.

(o) Qiratë

SNRF 16 zëvendëson udhëzimet ekzistuese për qiratë, duke përfshirë SNK 17 Qiratë. Standardi i ri sjell një model të vetëm kontabël të paraqitjes në bilanc të qirave nga qiramarrësit.

Standarti eliminon modelin aktual të kontabilitetit të dyfishtë për qiramarrësit dhe në vend të saj kërkon që shoqëritë të pasqyrojnë qiratë në bilanc sipas një modeli të vetëm, duke eliminuar dallimin mes qirasë operative dhe financiare.

